

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

NR.775 DATE 28.10.1996

P E R

KRIJIMIN E KESHILLIT KOMBETAR TE UJIT

Ne mbeshtetje te nenit 5 te ligjit nr.8093, date
21.3.1996 "Per rezervat ujore", me propozimin e Ministrise se
Puneve Publike, Rregullimit te Territorit dhe Turizmit,
Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Keshillit Kombetar te Ujit (KKU), si organ
qendror vendimor per administrimin e rezervave ujore e
Republikes se Shqiperise.

Keshilli Kombetar i Ujit kryen funksionet dhe detyrat e
percaktuara ne ligjin per rezervat ujore.

2. Keshilli Kombetar i ujit perbehet nga 7 anetare :

- Kryetari i Keshillit te Ministrave Kryetar i KKU
- Ministri i Puneve Publike,Rregullimit
te Territorit dhe Turizmit anetar
- Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit "
- Ministri i burimeve Minerare dhe Energjetike "
- Ministri i Shendetesise dhe Ambientit "
- Ministri i Financave "
- Ministri i Industrise,Transportit dhe
Tregtise "

3. Krijohet sekretariati teknik si organ ekzekutiv i KKU.
Ai kryen funksionet dhe detyrat e percaktuara ne ligjin per
rezervat ujore, si dhe kryen edhe funksionet e sekretarise
teknike te tij.

4. Keshilli Kombetar i Ujit funksionon sipas rregullores
perkatese te miratuar nga kryetari i ketij keshilli.

5. Vendimi i keshillit te Ministrave nr.125, date
21.2.1994 "Per krijimin e Keshillit Kombetar te Ujerve",
shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI